



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANE SH.A.



DEPARTAMENTI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

DREJTORIA E PROKURIMEVE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2018

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Operatorin Ekonomik “4AM” sh.p.k., me NIPT K92005016L, me seli në Adresën: Rruga Artan Lenja Pallati i 4 A-M, 8Aparamenti A1, kati i I-rë, Tiranë.

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur”

Numri i referencës së procedurës: REF-64148-04-20-2018

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Linjë Trasmetimi Ujësjiellësi nga Baseni i Presionit në dalje të tunelit Dajt-takimin me tubacionin e Depos Gurore (puseta e marrjes Fushe Dushk)”

Fondi Limit: 166.340.323 (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milion e treqind e dyzet mijë e treqind e njëzet e tre) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: Të ardhurat e SH.A Ujësjiellës-Kanalizime, Tiranë.

Kohëzgjatja: 180 ditë duke nisur nga data e dorëzimit të sheshit të punimeve.

Data e zhvillimit të tenderit është: 11/6/2018, 09:00

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr.17 të dates 30/04/2018

Njoftojmë se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “4-AM” sh.p.k.

K92005016L

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera: **164.556.567** (njëqind e gjashtëdhjetë e katër milion e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

2. Operatori Ekonomik “ANK” sh.p.k.

J92408001N

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera: **166.240.473** (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milion e dyqind e dyzetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tre) **lekë pa TVSH.**

3. Operatori Ekonomik “CURRI ” sh.p.k.

J67902718S

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera: **166.288.658** (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milion e dyqind e tetëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë) **lekë pa TVSH.**

4. Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “Lala” sh.p.k. & “Shansi Invest” sh.p.k

Shoqëria “Lala” sh.p.k

J76418903B

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shoqëria “Shansi Invest” sh.p.k

J61924002T

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera: **166.326.596** (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milion e treqind e njëzetë e gjashtë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) **lekë pa TVSH.**

5. Operatori Ekonomik “EGLAND ” sh.p.k.

J96829419D

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera: Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- 1. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “ANK” sh.p.k., me vlerë të ofertës 166.240.473 (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milion e dyqind e dyzetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

- *Autoriteti kontraktor në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti teknik ka kërkuar si më poshtë:*

18.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10).

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 12(dymbëdhjetë) ton dhe maksimumi 20(njëzetë) ton për secilin kamion	4 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5(pese) ton dhe maksimumi 10(dhjete) ton për secilin kamion	6 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome	3 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhirë	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	3 copë	Pronësi ose me qera
Autovinc	1 cope	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pike pese) ton dhe maksimumi 3.5(tre pike pese) ton për secilin kamionçinë	5 cope	Pronësi ose me qera
Makine per ngjitje tubash PE	2cope	Pronësi ose me qera
Tokmak elektrik	2cope	Pronësi ose me qera
Pompe uji	2 cope	Pronësi ose me qera
Matrapik	3 cope	Pronësi ose me qera
Vibrator	1 cope	Pronësi ose me qera
Motogjenerator	2 cope	Pronësi ose me qera
Saldatriçe	3 cope	Pronësi ose me qera
Motosharr	7 cope	Pronësi ose me qera
Eskavator me çekiç pneumatic ose hidraulik	1 copë	Pronësi ose me qera

Operatori ekonomik “ANK” shpk sh.p.k. në përmbushje të kriterit të mësipërm ka deklaruar në shtojcën nr.10 se disponojnë mjetet e mëposhtëme:

1. Kamion me targa AA289DZ me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e

- paraqitur për këtë mjet 24.8 Ton*
2. *Kamion me targa AA198LK me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 24.2 Ton*
 3. *Kamion me targa AA148PX me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 22.6 Ton*
 4. *Kamion me targa AA286DZ me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 27.5 Ton*

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion katër kamiona vetëshkarkues kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 12 ton dhe maximum 20 ton secili kamion për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik në përmbushje të këtij kriteri nga dy kamiona nuk ka paraqitur asnjë kamion me tonazhin e kërkuar nga AK.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10 , është i paplotë lidhur me kamionat vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 12 ton dhe maksimumi 20 ton për secilin kamion të kërkuar nga AK (4 cope), për rrjedhojë i pavlefshëm.

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion gjashtë kamiona vetëshkarkues kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 5 ton dhe maximum 10 ton secili kamion për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik në përmbushje të këtij kriteri nga dy kamiona nuk ka paraqitur asnjë kamion me tonazhin e kërkuar nga AK.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10 , është i paplotë lidhur me kamionat vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 5 ton dhe maksimumi 10 ton për secilin kamion të kërkuar nga AK (6 cope), për rrjedhojë i pavlefshëm.

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion pesë kamionçina vetëshkarkues kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 1.5 ton dhe maximum 3.5 ton secili kamionçinë për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik në përmbushje të këtij kriteri nuk ka paraqitur asnjë kamionçinë me tonazhin e kërkuar nga AK.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10 , është i paplotë lidhur me kamionçinat me kapacitet mbajtës minimumi 1.5 ton dhe maksimumi 3.5 ton për secilën kamionçinë të kërkuar nga AK (5 cope) , për rrjedhojë i pavlefshëm.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatorëve Ekonomik lidhur me shtojcën 10, është i paplotë, për rrjedhojë i pavlefshëm.

Gjithashtu vihet re se në shtojcën nr.10 të paraqitur nga operatori ekonomik mungojnë mjetet fadromë, eskavator, autobetonierë autovinç, autobot uji etj.

Sa më sipër operatori ekonomik nuk ka paraqitur mjetet e nevojshme të kërkuara nga AK, në dokumentat standarte të tenderit/ kriteret e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik, për rrjedhojë dokumentacioni i paraqitur lidhur me mjetet është i paplotë për rrjedhojë i pavlefshëm.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të

Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “CURRI” sh.p.k. me vlerë të ofertës 166.288.658 (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milion e dyqind e tetëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë pa tvsh

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

- *AK në Dokumentat Standarte te Tenderit në Kriteret e Veçanta ka kërkuar për realizimin e kontratës si më poshtë:*

dh. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

Për plotësimin e kriterit për shlyerjen e energjisë elektrike, shoqëria “CURRI” sh.p.k ka paraqitur dokumentacionin e mëposhtëm në portalin elektronik të APP-së për këtë procedurë prokurimi:

“Vërtetim debie” nr. 1122prot, datë 15.05.2018, lëshuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a, në emër të kërkuarit “CURRI” sh.p.k, ku evidentohet që: “... nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratën me Kod SH2A0100120355919... rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 14.05.2018, pa përfshirë faturën koherente të muajit Prill 2018”.

- Refruar Neni 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.
- Vërtetimi i Debisë i paraqitur në sistemin elektronik nga Operatori ekonomik nuk vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për periudhën më të fundit para hapjes së ofertave që tashmë ishte maturuar për procedurën e prokurimit konkretisht muajin Prill 2018 (i cili duhej të paguhej nga operatori ekonomik deri më datën 31.05.2018, këtu vlen të theksohet se ofertat ekonomike janë hapur më datën 11.06.2018).
- Nisur nga sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se Operatori ekonomik “CURRI” shpk, nuk plotëson Kriteret e Veçanta për Kualifikim pika 1 gërma “dh” të vendosur në DST, c’ka bie në kundërshtim me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma “c” ku ndër të tjera

citohet se ”Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankiminë gjykatë.”

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

3. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “EGLAND” sh.p.k. me vlerë të ofertës 0 (zero) lekë pa TVSH.

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “EGLAND” shpk nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike dhe dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar në Shtojcën 12, të dokumenteve të tenderit për këtë procedurë.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave. Mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik “EGLAND” shpk s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik dhe Formularin e Çmimit të Ofertës sipas Shtojcës 1 dhe preventivin e detajuar sipas zërave përkatës, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 12, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik “**4AM**” sh.p.k., me NIPT K92005016L me administrator Z. Ardit Metaliaj, me ofertë ekonomike me vlerë prej **164.556.567** (njëqind e gjashtëdhjetë e katër milion e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) **lekë pa TVSH**, se është **identifikuar si oferta e suksesshme**.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a me adresë rruga “5 Maji” pranë Medresesë, Tiranë, me nr tel: +355 4 2225572, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 18.06.2018.

Ankesa: Nuk ka

